

VENDIM
Nr. 331, datë 4.5.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohen individët e renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës, bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINAN-CUES
TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
(LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
ORGANIZATAT ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat
ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”;

1. TURKI; MUBARAK; ABDULLAH; AHMAD AL-BINALI
2. FAYSAL; AHMAD; BIN ALI;
AL-ZAHRANI
3. TUAH; FEBRIËANSYAH
4. HUSAYN; JUAYTHINI
5. MUHAMMAD; SHOLEH; IBRAHIM

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.